



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Qershor 2021

Nr: 408

V E N D I M

**PËR SHPËRNDARJEN E MANDATEVE MIDIS SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE
PËRCAKTIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU DURRËS PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25.04.2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 162 dhe 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për Kuvendin dhe për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo deputet, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 340, datë 4.05.2021 ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore Qarku Durrës. Kundër këtij vendimit, brenda afateve ligjore u paraqitën kërkesa ankimore ku midis të tjerash u kundërshtua dhe Vendimi i Komisionerit nr. 340. Komisioni i Ankimeve e Saksioneve me vendim nr. 90, datë 26.05.2021 ndryshoi Vendimin e Komisionerit nr. 340 duke përfshirë në Tabelën Përmbledhëse të rezultatit shifrat sipas rezultatit të dalë nga rinumërimi i 108 kutive të votimit për votat e subjekteve zgjedhore. Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve Kolegji Zgjedhor vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 90, datë 26.05.2021, të Komisionit të Ankimeve e Saksioneve.

Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Komisioneri në mbështetje të nenit 162, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, përlogarit shpërndarjen e mandateve për Kuvendin.

Në bazë të nenit 162, pika 1, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t’u përfshirë në përlogaritjen e shpërndarjes së mandateve janë:



Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1.	Partia Socialiste e Shqipërisë	768.134	48,67%
2.	Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"	622.187	39,42%
3.	Lëvizja Socialiste për Integrim	107.538	6,81%
4.	Partia Socialdemokrate	35.475	2,25%

Rezultati për Qarkun Durrës për subjektet zgjedhore, sipas vendimit nr. 90, datë 26.05.2021, të Komisionit të Ankimimeve e Saksioneve, është si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1	Partia Socialdemokrate	654	0.43%
2	Partia Balli Kombëtar	178	0.12%
3	Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare	338	0.22%
4	Partia Bindja Demokratike	329	0.22%
5	Koalicioni "Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët"	88	0.06%
6	Lëvizja Socialiste për Integrim	9.479	6.20%
7	Partia Nisma Thurje	666	0.44%
8	Partia Lëvizja e Re	422	0.28%
9	Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"	63.393	41.44%
10	Partia Aleanca Demokracia e Re	204	0.13%
11	Partia Lëvizja Për Ndryshim	338	0.22%
12	Partia Socialiste e Shqipërisë	76.898	50.26%
	Totali i votave të vlefshme	152.987	100,00%

Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t'u përfshirë në përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve kanë fituar vota si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	76.898
2	Koalicioni "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"	63.393
3	Lëvizja Socialiste për Integrim	9.479
4	Partia Socialdemokrate	654

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 14 (katërbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore qarku Durrës në bazë të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 7, datë 11.12.2020.

Subjekti zgjedhor/ pjesëtuesit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Herësit
PS	76898	38449	25633	19225	15380	12816	10985	9612	8544	
PD-AN	63393	31697	21131	15848	12679	10566	9056	7924	7044	
LSI	9479	4740	3160	2370	1896	1580	1354	1185	1053	
PSD	654	327	218	164	131	109	93	82	73	

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfutur nga çdo pjesëtim, renditen nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore qarku Durrës, pra 14. Nga kjo renditje marrim rezultatin si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Herësit
1	PS	76898
2	PD-AN	63393
3	PS	38449
4	PD-AN	31697
5	PS	25633
6	PD-AN	21131
7	PS	19225
8	PD-AN	15848
9	PS	15380
10	PS	12816
11	PD-AN	12679
12	PS	10985
13	PD-AN	10566
14	PS	9612

Në bazë të nenit 162, pika 5, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Sipas nenit 163, pika 1, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.

Shpërndarja e mandateve fillon me rend zbritës, në bazë të renditjes së tyre në listën shumëmemërore, duke filluar nga numri rendor një, si dhe numrit të votës parapëlqyese të secilit kandidat.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Durrës, për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas vendimit nr. 90, datë 26.05.2021, të Komisionit të Ankimimeve e Saksioneve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PS			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Milva	Vilson	Ekonomi	F	3.739
2	Alban	Viktor	Xhelili	M	2.148
3	Jurgis	Shefqet	Çyrbja	M	6.583
4	Klodiana	Fatmir	Spahiu	F	2.731
5	Ilir	Muhamed	Ndraxhi	M	3.556
6	Rrahman	Rexhep	Rraja	M	7.759
7	Lefter	Haki	Koka	M	9.609
8	Edi	Kristaq	Rama	M	15.871
9	Ana	Vladimir	Dhamo	F	2.031
10	Artan	Nazmi	Bitri	M	767
11	Keida	Ramazan	Bejaj	F	493
12	Arkend	Bashkim	Balla	M	2.463
13	Denis	Mehmet	Deliu	M	2.848
14	Klementina	Kadri	Meçi	F	948
15	Erjon	Shërbet	Meka	M	2.228
Gjithsej					63.774

Sipas nenit 163, pika 3, të Kodit Zgjedhor, në fillim përfitojnë mandat kandidatët që kanë marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara nga subjekti në zonën zgjedhore. Në çdo rast, herësi nuk mund të jetë më shumë se 10 mijë vota.

Për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë herësi është 9695. Nuk rezulton të ketë kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 8 (tetë) të mandateve të fituara nga ky subjekt. Në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Durrës, për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, sipas vendimit nr. 90, datë 26.05.202, të Komisionit të Ankimimeve e Sanksioneve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PD-AN			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Edi	Antonin	Paloka	M	4.212
2	Agron	Enver	Duka	M	4.731
3	Merita	Gezim	Bakui	F	3.159
4	Oerd	Eqrem	Bylykbashi	M	3.756
5	Ferdinant	Mynyr	Xhaferaj	M	6.080
6	Andia	Sulejman	Ulliri	F	5.595
7	Igli	Latif	Cara	M	6.952

8	Rezeart	Xhelal	Tusha	M	3.875
9	Manjola	Ramiz	Luku	F	6.108
10	Florian	Kujtim	Tahiri	M	1.475
11	Agim	Nazif	Baçi	M	685
12	Blerina	Niazi	Reçi	F	1.035
13	Selman	Mustafa	Tema	M	2.120
14	Erzen	Agim	Laçi	M	2.222
15	Merita	Shefki	Dakovelli	F	553
Gjithsej					52.558

Për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” herësi është 10572, pra merret 10000. Nuk rezulton të ketë kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 6 (gjashtë) të mandateve të fituara nga ky subjekt. Në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 162 dhe 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V E N D O S :

1. Të shpërndaj mandatet për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Durrës, si më poshtë:

- | | |
|---|-----------|
| a) Partia Socialiste e Shqipërisë | 8 mandate |
| b) Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” | 6 mandate |

2. Të shpall kandidatët fitues për deputetë nga lista shumemërore të miratuara nga KQZ e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për Qarkun Durrës si më poshtë:

- | | | |
|------------|---------|---------|
| 1 Milva | Vilson | Ekonomi |
| 2 Alban | Viktor | Xhelili |
| 3 Jurgis | Shefqet | Çyrbja |
| 4 Klodiana | Fatmir | Spahiu |
| 5 Ilir | Muhamed | Ndraxhi |
| 6 Rrahman | Rexhep | Rraja |
| 7 Lefter | Haki | Koka |
| 8 Edi | Kristaq | Rama |

3. Të shpall kandidatët fitues për deputetë nga lista shumemërore të miratuara nga KQZ e subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – “Aleanca për Ndryshim” për Qarkun Durrës si më poshtë:

1	Edi	Antonin	Paloka	PD
2	Agron	Enver	Duka	P.A.A
3	Merita	Gezim	Bakiu	PD
4	Oerd	Eqrem	Bylykbashi	PD
5	Ferdinant	Mynyr	Xhaferaj	PD
6	Andia	Sulejman	Ulliri	PLL

4. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave si më poshtë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
9	Denis	Mehmet	Deliu	M	2.848
10	Arkend	Bashkim	Balla	M	2.463
11	Erjon	Shërbet	Meka	M	2.228
12	Ana	Vladimir	Dhamo	F	2.031
13	Klementina	Kadri	Meçi	F	948
14	Artan	Nazmi	Bitri	M	767
15	Keida	Ramazan	Bejaj	F	493

5. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – “Aleanca për Ndryshim”, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave si më poshtë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
7	Igli	Latif	Cara	M	6.952
8	Manjola	Ramiz	Luku	F	6.108
9	Rezeart	Xhelal	Tusha	M	3.875
10	Erzen	Agim	Laçi	M	2.222
11	Selman	Mustafa	Tema	M	2.120
12	Florian	Kujtim	Tahiri	M	1.475
13	Blerina	Niazi	Reçi	F	1.035
14	Agim	Nazif	Baçi	M	685
15	Merita	Shefki	Dakovelli	F	553

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

